

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra e Presidentit - Ured Predsednika - Office of the President

Nr. Prot.:
Br. Prot.:
Prot. No.: 315

Datë:
Datum:
Date: 07 / 03 / 2017

PRISHTINE/A



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKO KOSOVO – PREDSEDIK

Prishtinë, 7 mars 2017

Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës

I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Veseli,
Të nderur/a anëtar/e të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 4(3), nenit 79 dhe nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), nenit 5 dhe nenit 7 të Ligjit nr. 04/-L-025 për nisma legjislativë (Gazeta Zyrtare, nr. 23, 26 tetor 2011), dhe nenit 53 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës (29 prill 2010), Ju propozoj Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Republika e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial si dhe ruajtjes së paqes dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, duhet të avancojë rolin dhe detyrat e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës rregullon misionin, funksionimin dhe detyrat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe kushtet e përgjithshme të shërbimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës.


Në këtë drejtim, përmes Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës do të ketë për mision që të mbrojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, qytetarët dhe komunitetet, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës, si dhe të kontribuojë në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal si dhe atij global.

Besoj që brenda periudhës të duhur kohore, siç është paraparë me legjislacionin në fuqi, do të procedoni Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës për miratim nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me respekt!



telegrafi.com


Hashim THAÇI
President i Republikës së Kosovës

Bashkangjitur:

Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra e Presednikut / Büro des Präsidenten / Office of the President

Prot. No. 315 Data: 07 / 03 / 2017
PRISHTINË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKO KOSOVO – PRESDENIK

Priština, 7. mart 2017. godine

Predsedništvu Skupštine Republike Kosova

Poštovani predsedniče Skupštine Republike Kosova, g. Veseli,
Poštovani/ poštovane članovi/ članice Predsedništva Skupštine Republike
Kosova,

U skladu sa članom 4 (3), članom 79 i članom 84 Ustava Republike Kosova, članom 6 Zakona Br. 03/L-094, o predsedniku Republike Kosova (Službeni list, br. 47, 25. januar 2009. godine), članom 5 i članom 7 Zakona br. 04/-L-025 o zakonodavnim inicijativama (Službeni list, br. 23, 26. oktobar 2011. godine), i članom 53 Uredbe Skupštine Republike Kosova (29. april 2010. godine), predlažemo vam nacrt Zakona o Bezbednosnim snagama Kosova.

Republika Kosovo, s ciljem zaštite suvereniteta i teritorijalnog integriteta i očuvanja mira i zaštite državnih interesa, treba da unapredi ulogu i obaveze Bezbednosnih snaga Kosova.

Nacrt Zakona o Bezbednosnim snagama Kosova uređuje misiju, funkcije i obaveze Bezbednosnih snaga Kosova.

U tom pravcu, preko Zakona o Bezbednosnim snagama Kosova, bezbednosne snage Kosova će za misiju imati odbranu suvereniteta i teritorijalnog integriteta Republike Kosova, građana i zajednica, imovine i interesa Republike Kosova, kao i da doprinesu izgradnji i očuvanju regionalnog i globalnog mira i stabilnosti.

Verujem da ćete blagovremeno, kako je to predviđeno i zakonodavstvom na snazi, procesirati nacrt Zakona o Bezbednosnim snagama Kosova na usvajanje od strane Skupštine Republike Kosova.

S poštovanjem!

Hashim THAČI



Predsednik Republike Kosova

Priloženo:

Nacrt Zakona o Bezbednosnim snagama Kosova, na albanskom, srpskom i engleskom jeziku.

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra e Presidentit / Ured Predsednika - Office of the President

Nr. Prot.: 315 Data: 07 / 03 / 2017
Br. Prot.:
Prot. No.:

PRISHTINË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKO KOSOVO – PRESEDNIK

Prishtina, March 07, 2017

To the Presidency of the Assembly of the Republic of Kosovo

Honorable President of the Assembly of the Republic of Kosovo, Mr. Veseli,
Honorable members of the Presidency of the Assembly of the Republic of
Kosovo,

Pursuant to Article 4 (3), Article 79 and Article 84 of the Constitution of the Republic of Kosovo, Article 6 of Law No. 03/L-094, on the President of the Republic of Kosovo (Official Gazette, no. 47, January 25, 2009), Article 5 and Article 7 of Law No. 04/L-025 on legislative initiatives (Official Gazette, no. 23, October 26, 2011), and Article 53 of the Regulation of the Assembly of the Republic of Kosovo (April 29, 2010), I propose to You the Draft Law on the Kosovo Security Force.

The Republic of Kosovo, with the purpose of protecting the sovereignty and territorial integrity and the preservation of peace and the protection of state interests, should advance the role and tasks of the Kosovo Security Force.

The Draft Law on the Kosovo Security Force regulates the mission, functioning and tasks of the Kosovo Security Force, its organization and other issues related to the activities and general conditions of the service in the Kosovo Security Force.

In this regard, through the Law on the Kosovo Security Force, the Kosovo Security Force will have the mission to protect the sovereignty and territorial integrity of the Republic of Kosovo, the citizens and communities, the property and interests of the Republic of Kosovo, and contributes in building and maintaining peace and regional and global stability.

I believe that within an appropriate period of time, as foreseen by the legislation in force, you will proceed the Draft Law on the Kosovo Security Force for approval by the Assembly of the Republic of Kosovo.

Respectfully!



telegrafi.com

Hashim THAÇI

President of the Republic of Kosovo

Attached:

The Draft Law on the Kosovo Security Force, in Albanian, Serbian and English.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

 PROJEKTLIGJI
PËR
FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

PROJEKTLIGJI PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

KREU I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj rregullon misionin, funksionimin dhe detyrat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe kushtet e përgjithshme të shërbimit në Forcën e Sigurisë të Kosovës.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky ligj zbatohet për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përfshirë pjesëtarët aktivë, rezervë, kadetët, rekrutët dhe personelin civil të saj.

Neni 3

Përkufizimet

1. Për zbatim të këtij ligji, shprehjet dhe termet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet si në vijim:

- 1.1. **FSK-** Forca e Sigurisë së Kosovës;
- 1.2. **Kuvend-** Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- 1.3. **Kushtetuta** - Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- 1.4. **President** – Presidenti i Republikës së Kosovës;
- 1.5. **Qeveria** – Qeveria e Republikës së Kosovës;
- 1.6. **Kryeministri** – Kryeministri i Republikës së Kosovës;
- 1.7. **Ministri** - Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës;
- 1.8. **Ministria/MFSK** - Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës;
- 1.9. **KOMFSK** –Komandanti i FSK-së;
- 1.10. **Pjesëtar i FSK-së** - është shtetasi që shërben në Forcën e Sigurisë së Kosovës, nën betimin ushtarak dhe mban uniformën me simbolet përkatëse;
- 1.11. **Pjesëtar aktiv i FSK-së** - është shtetasi, puna primare e të cilit është në komponentin aktiv të FSK-së, si oficer, nënoficer apo ushtar;

- 1.12. **Pjesëtar rezervë i FSK-së**- është shtetasi, puna dytësore e të cilit është shërbimi në komponentin rezervë të FSK-së, si oficer, nënoficer, ushtar rezervë. Gjatë kohës kur angazhohet në shërbim, pjesëtari rezervë është pjesëtar aktiv i FSK-së;
- 1.13. **Personeli civil në FSK**- janë nëpunësit civilë të cilët shërbejnë në FSK në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;
- 1.14. **Përdorimi i forcës** - përfshin por nuk kufizohet vetëm në përdorimin e llojeve të veçanta të armëve të zjarrit, armëve, pajisjeve dhe mjeteve në përdorim, pa përjashtuar edhe përdorimin e forcës fizike.

KREU II – PARIMET E PËRGJITHSHME TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Neni 4

Misioni

1. FSK mbrohet sovranitetin dhe integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës, si dhe kontribuon në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal dhe global.
2. FSK është forcë ushtarake profesionale, e armatosur, një dhe unike, për të gjithë Republikën e Kosovës dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit, në pajtim me mandatin e dhënë kushtetues dhe ligjor.

Neni 5

Detyrat

1. Në zbatim të misionit të saj, detyrat e përgjithshme të FSK-së janë:
 - 1.1. të mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. të japë mbështetje ushtarake për autoritetet civile;
 - 1.3. t'iu japë mbështetje dhe ndihmë qytetarëve dhe komuniteteve;
 - 1.4. të marrë pjesë në operacionet ndërkombëtare humanitare dhe të paqes.
 - 1.5. të kryejë detyra tjera të parapara me ligjin në fuqi.

Neni 6

Armatimi

FSK do të jetë e pajisur me armatim adekuat, në përputhje me nevojat e FSK-së, për kryerjen e misionit dhe detyrave të saj.

Neni 7

Rekrutimi

1. Rekrutimi në FSK është vullnetar.
2. FSK pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarët e saj rekrutohen nga shtetasit e Republikës së Kosovës.

Neni 8

Paanshmëria politike

1. FSK nuk mund të përdoret për qëllime politike apo për veprimtari partiake.
2. Pjesëtarët e FSK-së për shkak të detyrës ose shërbimit të tyre nuk mund:
 - 2.1. të jenë anëtarë të partive politike, organizatave ose shoqatave me karakter politik;
 - 2.2. të marrin pjesë në veprimtaritë politike që organizohen prej tyre e as nuk mund të shfaqin shenja të përkrahjes së cilësdo prej tyre, dhe
 - 2.3. të hyjnë në grevë.
3. Ky nen nuk e mohon realizimin e të drejtës së pjesëtarëve të FSK-së për të votuar.

Neni 9

Ligji i aplikueshëm

1. Të gjithë pjesëtarët e FSK-së u nënshtrohen ligjeve të aplikueshme në Kosovë.
2. Pjesëtarët e FSK-së ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi si dhe në Kodin e Mirësjelljes dhe Kodin Disiplinor.
3. Gjatë shërbimit jashtë kufijve territorial të Republikës së Kosovës, pjesëtarët e FSK-së u nënshtrohen ligjeve të Republikës së Kosovës dhe të vendit nikoqir, përveç nëse është vendosur ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 10

Simbolet

1. Simbolet e FSK-së janë: flamuri, himni, stema e FSK-së dhe emblemat e njësive të FSK-së.
2. Flamuri dhe himni i Republikës së Kosovës janë flamuri dhe himni i FSK-së.
3. Flamuri i Republikës së Kosovës, stema e FSK-së së dhe emblema e njësive të FSK-së barten nga të gjithë pjesëtarët e FSK-së.
4. Komandanti i FSK-së, përmes Ministrit, propozon stemën e FSK-së, emblemat e njësive të saj dhe dukjen e gradave për miratim nga Presidenti.
5. FSK dhe njësitë e saj përdorin edhe flamujt dallues, sipas stemës së FSK-së dhe emblemave të njësive.
6. Askush nuk është i autorizuar të riprodhojë apo të përdorë stemën e FSK-së dhe emblemat e njësive të saj, pa autorizim me shkrim të Ministrit.
7. Përdorimi i simboleve dhe gradave përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 11

Rregullat e përdorimit të forcës

1. FSK është e autorizuar ta përdorë forcën, armët e zjarrit, mjetet dhe pajisjet që i ka në përdorim me qëllim të përmbushjes së misionit të dhënë kushtetues dhe ligjor, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitimë të FSK-së.
2. Përdorimi i forcës bëhet:
 - 2.1. kur cenohet sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës nga forca ushtarake të huaja, si dhe nga grupe të armatosura nga jashtë ose nga brenda. Në këto raste zjarri hapet me urdhër të komandës eprorë;
 - 2.2. si mjet për të ndaluar ose paralizuar veprimet e kundërligjshme të personit ose personave, kur mjetet e tjera nuk kanë dhënë rezultat ose kur duket qartë se përdorimi i tyre nuk do të ketë sukses;
 - 2.3. për të mbrojtur jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tyre legjitime ose të një tjetri nga një sulm i pashmangshëm, i vërtetë dhe i çastit, dhe i paprovokuar, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit;
 - 2.4. kur persona të armatosur ose me mjete të tjera tentojnë të hyjnë me forcë në zona e objekte të ndaluara ushtarake, të ruajtura nga roja e armatosur;
 - 2.5. kur persona të ndryshëm përpiqen të futen me forcë ose me automjete në zona të ndaluara, apo në objekte të rëndësishme të veçantë të caktuara me akte ligjore, nënligjore, ose në objekte që janë marrë në ruajtje.
3. Në misione jashtë vendit përdorimi i armëve të zjarrit bëhet sipas rregullave të angazhimit, të miratuara nga autoriteti kompetent, në zbatim të misionit të caktuar dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm e atë ndërkombëtar.
4. Para përdorimit të armëve të zjarrit sipas nën-paragrafëve 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5, të këtij neni, personat ndaj të cilëve ato do të përdoren, duhet të paralajmërohen me zë të lartë e të qartë.
5. Kur rrethanat nuk lejojnë në asnjë mënyrë zbatimin e paralajmërimit, armët e zjarrit përdoren pa paralajmërim. Në këto raste, shkalla e forcës së përdorur nuk guxon të jetë më e madhe sesa ajo e nevojshmja për të kryer detyrat dhe arritur objektivat e dhëna të misionit. Forca e përdorur duhet të jetë e kufizuar për nga shkalla, intensiteti dhe kohëzgjatja e nevojshme për arritjen e objektivit. Në rastet e përdorimit të forcës, pjesëtari i Forcës së Sigurisë së Kosovës duhet të përpiqet ta minimizojë ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e personit dhe të minimizojë çfarëdo pasojë të dëmshme.
6. Me ndërprerjen, pushimin, përfundimin e sulmit ose dorëzimin e sulmuesit, duhet të ndërpritet edhe përdorimi i armëve të zjarrit.
7. FSK, kur përdor armët e zjarrit në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, përgjigjet sipas Kodit Penal.
8. Rregullat e angazhimit të FSK-së, në operacione brenda vendit miratohen nga Komandanti i FSK-së.
9. Rregullat për bartjen e armëve, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 12

Përdorimi i pronës së personave të tretë

1. FSK është e autorizuar që përkohësisht të marrë apo të përdorë çfarëdo prone, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në mjetet e transportit, të komunikimit ose të mbrojtjes, që janë në posedim të cilitdo person juridik apo fizik, mirëpo vetëm atëherë kur është e domosdoshme për të arritur një objektiv urgjent të FSK-së, që kërkon veprim të menjëhershëm apo në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme.
2. Prona që merret në përdorim duhet t'i kthehet personit nga i cili është marrë menjëherë pasi të mos jetë më e nevojshme që të arrihen objektivat urgjente të FSK-së, apo pas kalimit të gjendjes së jashtëzakonshme, për çka edhe është marrë.
3. Qeveria do të jetë përgjegjëse për dëmet apo lëndimet e shkaktuara personave fizikë ose juridikë si rezultat i veprimeve të pjesëtarëve të FSK-së në kryerjen apo në ndërlidhje me kryerjen e detyrave të tyre. Për zbatimin e këtij paragrafi Qeveria nxjerrë akt nënligjor.

Neni 13

Mobilizimi

1. Mobilizimi i FSK-së bëhet në kohë paqeje dhe në rastet e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme.
2. Mobilizimi në kohë paqeje bëhet me urdhër të Komandantit të FSK-së, sipas planifikimit dhe kërkesave operacionale.
3. Në rastet e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, mobilizimi i FSK-së bëhet me urdhër të Presidentit.
4. Në gjendje të jashtëzakonshme, FSK ka autorizim t'i përdorë astetet shtetërore dhe private në përmbushje të misionit kushtetues dhe ligjor.

Neni 14

Rezervat për qëndrueshmëri operacionale

1. FSK do të ketë rezerva për qëndrueshmëri operacionale.
2. Përcaktimi dhe përdorimi i rezervave për qëndrueshmëri operacionale bëhet sipas aktit të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

Neni 15

Standardizimi

1. Standardizimi në FSK bëhet në tri fusha: administrativ, operacional dhe material.
2. Përcaktimi i standardizimit sipas paragrafit 1, të këtij neni, bëhet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

KREU III - KONTROLLI CIVIL DHE MBIKËQYRJA DEMOKRATIKE E FSK-SË

Neni 16

Kontrolli civil dhe mbikëqyrja

1. FSK i nënshtrohet kontrollit civil demokratik, sundimit të ligjit dhe obligimeve ndërkombëtare.
2. Kuvendi, Presidenti, Kryeministri dhe Ministri përbëjnë zinxhirin e kontrollit civil dhe mbikëqyrjes demokratike të FSK-së, siç është përcaktuar me Kushtetutë, me këtë ligj dhe me ligjet tjera përkatëse.

Neni 17

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit

1. Kuvendi, ka kompetencë:
 - 1.1. të ushtrojë kontroll demokratik parlamentar mbi FSK;
 - 1.2. të miratojë buxhetin vjetor të FSK-së;
 - 1.3. të miratojë programe të veçanta financiare për mbështetje të FSK-së, sipas propozimit të Kryeministrit;
2. Në kuadër të Kuvendit funksionon Komisioni përkatës Parlamentar për FSK-ën, si organ i pavarur mbikëqyrës, me kompetencë që sipas nevojës të kërkojë:
 - 2.1. raport nga Ministri dhe Komandanti i FSK-së. I njëjti raport i dërgohet Presidentit;
 - 2.2. praninë e Ministrit dhe Komandantit të FSK-së në takimet e tyre dhe t'iu përgjigjet pyetjeve të Komisionit.

Neni 18

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Presidentit

1. Presidenti është Komandant Suprem i FSK-së.
2. Presidenti në kohë paqeje e ushtron drejtimin e FSK-së nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit, ndërsa në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, e drejton FSK-në drejtpërdrejtë ose përmes Komandantit të FSK-së.
3. Në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, Presidenti ka kompetenca të urdhërojë:
 - 3.1. mobilizimin e FSK-së;
 - 3.2. vendosjen e shkallës së gatishmërisë së FSK-së, sipas nivelit të rrezikut;
 - 3.3. lëvizjen, rivendosjen dhe përdorimin e FSK-së;
4. Në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet tjera përkatëse, Presidenti ka kompetencë që:
 - 4.1. të emërojë, të gradojë, të shkarkojë dhe të lirojë Komandantin e FSK-së, pas rekomandimit nga Kryeministri;
 - 4.2. të bëjë gradimet, emërimet, shkarkimet dhe lirimet nga detyra në gradën e Gjeneralit;
 - 4.3. të miratojë planin e vendosjes së FSK-së në kohë paqeje (lokacionet), pas rekomandimit të Kryeministrit;

- 4.4. të miratojë skemën e strukturës organizative të FSK-së;
 - 4.5. të miratojë stemën e FSK-së, emblemat e njësive, dukjen e gradave dhe uniformave të FSK-së;
 - 4.6. të ndajë dekorata, medalje dhe mirënjohje.
5. Si Komandant Suprem i FSK-së, Presidenti, nxjerr urdhra, udhëzime dhe akte tjera të nevojshme për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi që ka.

Neni 19

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryeministrit

1. Kryeministri ka kompetencë që në mënyrë efektive ta mbikëqyrë dhe të ushtrojë kontroll mbi FSK-ën, përmes Ministrit.
2. Kryeministri ka kompetencë që:
 - 2.1. t'i rekomandojë Presidentit, emërimin, gradimin, shkarkimin dhe lirimin nga detyra të Komandantit të FSK-së;
 - 2.2. t'i rekomandojë Presidentit, planin e vendosjes së FSK-së në kohë paqeje;
 - 2.3. të përcaktojë trajtimin ekonomik të personelit të FSK-së dhe të personelit civil, që shërben në Ministrinë e FSK-së dhe FSK-ën me propozimin e Ministrit;
 - 2.4. t'i propozojë Kuvendit programe të veçanta financiare për mbështetje të FSK-së;
 - 2.5. të angazhojë FSK-ën për t'i ndihmuar autoritetet civile në përgjigje të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive apo aksidenteve tjera.

Neni 20

Këshilli i Sigurisë së Kosovës

1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës, merr në shqyrtim dhe këshillon edhe në lidhje me të gjitha çështjet e ndërlidhura me mbrojtjen e Republikës së Kosovës, përfshirë përdorimin e FSK-së.
2. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në raport me FSK-ën, përcaktohen me ligj të veçantë.
3. Gjatë shqyrtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë, Këshilli i Sigurisë së Kosovës mund të kërkojë asistencën e personelit të FSK-së, sipas nevojës.

Neni 21

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

1. Ministria është e organizuar si Ministri e Integruar në kuadër të së cilës funksionojnë strukturat politike, ushtarake dhe civile.
2. Ministria ka strukturën e saj organizative që siguron funksionalizimin e plotë dhe përmbushjen e përgjegjësi të saj. Personeli civil i punësuar në Ministri dhe në FSK ruan parimin e ekuivalencës në shërbim me gradat ushtarake.
3. Ministria harton dhe zbaton politikat e përgjithshme shtetërore të mbrojtjes në nivelin strategjik, si dhe ushtron funksionet e kompetencat e saj në përputhje me Kushtetutën, me këtë

ligj, me Strategjinë e Sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Strategjinë e Mbrojtjes, si dhe legjislacionin në fuqi.

4. Ministria është kompetente për:

- 4.1. hartimin e dokumenteve strategjike të mbrojtjes;
- 4.2. hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore nga fushëveprimi i Ministrisë dhe FSK-së;
- 4.3. zhvillimin e politikave për integrim dhe anëtarësim të FSK-së në strukturat ndërkombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë;
- 4.4. hartimin e politikave për zhvillimin, modernizimin dhe standardizimin e FSK-së;
- 4.5. zgjerimin dhe thellimin e marrëdhënieve rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes;
- 4.6. hartimin e politikave për edukimin dhe stërvitjen për gjithë personelin e FSK-së;
- 4.7. hartimin e programeve të bashkëpunimit me institucionet shtetërore në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë;
- 4.8. hartimin e politikave për menaxhimin e burimeve njerëzore në Ministri dhe FSK;
- 4.9. planifikimin, programimin, buxhetimin dhe ekzekutimin e projekteve të MFSK-së dhe FSK-së;
- 4.10. bashkëpunimin me institucionet kompetente për përfaqësimin gjyqësor në mbrojtje të interesave të MFSK-së dhe FSK-së;
- 4.11. mbikëqyrjen dhe menaxhimin e të gjitha veprimtarive të inteligjencës ushtarake dhe informacioneve të klasifikuara;
- 4.12. zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve në fushën e bashkëpunimit civilo-ushtarak (CIMIC);
- 4.13. mbikëqyrjen dhe inspektimin e FSK-së;
- 4.14. menaxhimin e infrastrukturës dhe pajisjeve, të cilat i janë ndarë MFSK-së dhe FSK-së;
- 4.15. zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve të mbështetjes logjistike;
- 4.16. zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe organizimin e sistemit të komunikimit;
- 4.17. zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave, planeve dhe programeve mjekësore dhe përkujdesjes shëndetësore për MFSK-në dhe FSK-në;
- 4.18. zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve lidhur me marrëdhëniet me publikun dhe protokollin;
- 4.19. hartimin e politikave për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe çështje të komuniteteve.
- 4.20. kryen edhe detyra të tjera të përcaktuar me ligj dhe akte tjera nënligjore në fuqi.

5. Sekretari i Përgjithshëm është udhëheqësi më i lartë administrativ i Ministrisë dhe i raporton drejtpërdrejt Ministrit, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Sekretari i Përgjithshëm, në veçanti ka këto përgjegjësi dhe kompetenca:

- 5.1. menaxhon nëpunësit civilë dhe të uniformuar të Ministrisë dhe të FSK-së ;
- 5.2. menaxhon financat dhe burimet tjera të MFSK-së dhe FSK-së ;
- 5.3. menaxhon rrjedhën e informacionit në MFSK;
- 5.4. sipas nevojës, raporton para Komisionit përkatës parlamentar për çështjet e mbrojtjes;

- 5.5. kryen edhe detyra të tjera të përcaktuar me ligj dhe akte tjera nënligjore në fuqi.
6. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në Ministri përcaktohet me akt të veçantë nënligjor, duke marrë parasysh këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 22

Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës

1. Ministri është autoriteti më i lartë i drejtimit politik të Ministrisë dhe ushtron kontroll e administrim të përgjithshëm të FSK-së.
2. Ministri:
 - 2.1. përfaqëson Republikën e Kosovës në nivel ndërkombëtar në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë;
 - 2.2. i rekomandon Kryeministrit, në bashkëpunim me KOMFSK, programet e veçanta në fushën e mbrojtjes që kërkojnë mbështetje financiare;
 - 2.3. inicion dhe propozon të gjitha dokumentet e nevojshme të politikave, planet afatgjata të zhvillimit lidhur me FSK-ën për t'u shqyrtuar nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës;
 - 2.4. i propozon Kryeministrit emërimin, gradimin, shkarkimin dhe lirimën nga detyra të Komandant të FSK-së;
 - 2.5. i propozon Kryeministrit planin e vendosjes së FSK-së në kohë paqeje;
 - 2.6. mbikëqyr dhe inspekton FSK-në, përmes inspektorit gjeneral.
3. Ministri, sipas rekomandimit të Komandantit të FSK-së, i propozon Presidentit:
 - 3.1. emërimet, gradimet, shkarkimet dhe lirimet në gradën e Gjeneralit;
 - 3.2. skemën e strukturës organizative të FSK-së;
 - 3.3. stemën e FSK-së, emblemat e njësisë, dukjen e gradave dhe uniformave të FSK-së.
4. Ministri, në koordinim me KOMFSK, propozon emërimet dhe tërheqjen e atasheve ushtarakë pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës;
5. Autoriteti i ministrit nuk përfshinë menaxhimin operacional të FSK-së.
6. Ministri, përveç përgjegjësisë të përcaktuara me këtë ligj, ushtron edhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 23

Komandanti i FSK-së

1. Ministri, i propozon Kryeministrit një kandidat të përshtatshëm për t'u emëruar Komandant i FSK-së nga Presidenti. Që të jetë i përshtatshëm për t'u marrë në shqyrtim, kandidati duhet të ketë mbajtur gradën e Gjeneralmajorit së paku dymbëdhjetë muaj.
2. Komandanti i FSK-së bën betimin para Presidentit.
3. Komandanti i FSK-së i përgjigjet Ministrit.
4. Komandanti i FSK-së është autoriteti më i lartë ushtarak në gradë dhe detyrë i gjithë personelit të FSK-së dhe të gjitha njësitë e FSK-së operojnë nën Komandën e Komandantit të FSK-së.

5. Komandanti i FSK-së ushtron komandë të plotë mbi FSK dhe elementin e saj rezervë dhe është përgjegjës:
- 5.1. për drejtimin, stërvitjen, mbikëqyrjen dhe aktivitetet e FSK-së;
 - 5.2. për dorëzimin e raportit vjetor tek Komisioni përkatës parlamentar dhe t'u përgjigjet personalisht pyetjeve të Komisionit kur të kërkohet një gjë e tillë;
 - 5.3. për mbikëqyrjen dhe sigurimin e ekzekutimit të të gjithë urdhrave të ligjshëm sipas udhëzimeve të Ministrit dhe Presidentit;
 - 5.4. për planifikimin dhe zbatimin e angazhimit të FSK-së;
 - 5.5. të përfaqëson Forcën e Sigurisë së Kosovës në takimet e niveleve të shefave të mbrojtjes;
 - 5.1. të propozojë për miratim nga Presidenti, përmes Ministrit, skemën e strukturës organizative të FSK-së;
 - 5.6. të miratojë dokumente në nivelin strategjik ushtarak, që kanë të bëjnë me funksionimin e FSK-së;
 - 5.7. të nxjerrë urdhra dhe Procedura Standarde Operative brenda përgjegjësi dhe detyrave që ka;
 - 5.8. të veprojë si këshilltar kryesor i Presidentit, Kryeministrit dhe Këshillit të Sigurisë së Kosovës, anëtar i të cilit është edhe ai, mbi çështjet që kanë të bëjnë me FSK-së;
 - 5.9. të sigurojë gatishmërinë operationale të FSK-së dhe të miratojë të gjitha planet operationale;
 - 5.10. të rekomandojë gradimin e personelit në gjitha gradat e Gjeneralëve;
 - 5.11. të veprojë si përfaqësues ndërkombëtar i Kosovës në çështjet e FSK-së në nivel të Shefave të Mbrojtjes;
 - 5.12. të përgatitë planet strategjike operationale të mbrojtjes dhe t'i dërgojë për miratim nga Presidenti.
6. Komandanti i FSK-së është autoritet për emërime dhe shkarkime të të gjitha gradave për personelin e Forcave të Armatosura, sipas propozimeve të Bordeve përkatëse. Komandanti i FSK-së më së shumti ka gradën e Gjenerallejtënantit dhe është oficeri me gradën më të lartë në FSK.
7. Komandanti i FSK-së emërohet me mandat 5 (pesë) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat tjetër.
8. Mandati i Komandantit të FSK-së KOMFSK përfundon me:
- i. dorëheqje;
 - ii. shkarkim;
 - iii. paaftësi shëndetësore;
 - iv. arritjen e moshës për pension;
9. Shkarkimi i Komandantit të FSK-së bëhet në rastet e shkelje së Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës dhe kryerjen e akteve dhe sjelljeve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Komandantit të FSK-së. Dispozitat për përfundimin e mandatit dhe shkarkimit përshtatshmërisht zbatohen edhe për gradat e gjeneralëve.
10. Përveç përgjegjësi të përcaktuara me këtë ligj, Komandanti i FSK-së ushtron edhe përgjegjësi të përcaktuara me ligje të tjera.

KREU IV - FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS

Neni 24

Statusi i FSK-së

1. FSK funksionon nën autoritetin e Ministrit dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Komandantit të FSK-së.
2. FSK është shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
3. FSK është person juridik.
4. FSK vepron nëpërmjet zinxhirit të unifikuar komandues në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 25

Organizimi dhe struktura e FSK-së

1. FSK përbëhet nga personeli profesional aktiv, rezervë, kadetë, rekrutë dhe personeli civil.
2. FSK përbëhet nga një komponentë aktive prej më së shumti pesë mijë (5000) pjesëtarë dhe nga një komponentë rezervë prej më së shumti tre mijë (3000) pjesëtarë.
3. FSK përbëhet nga Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së i cili përfshinë njësitë pranë shtabore dhe komandat.
4. Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së, me së paku njësitë pranë shtabore si në vijim:
 - 4.1. Akademia Ushtarake;
 - 4.2. Policia e Forcës;
 - 4.3. Njësia e Komunikimit;
 - 4.4. Njësia Ajrore;
 - 4.5. Njësia Mbështetëse;
5. Komandat e Shtabit të Përgjithshëm janë:
 - 5.1. Komanda e Forcës Tokësore;
 - 5.2. Garda Kombëtare;
 - 5.3. Komanda e Logistikës dhe
 - 5.4. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes.
6. Organizimi dhe funksionimi i FSK-së përcaktohet me akt të veçantë të nxjerrë nga Komandanti i FSK-së, në pajtim me këtë ligj dhe skemën e strukturës organizative të FSK-së, të miratuar nga Presidenti.
7. Komponenti rezervë i FSK-se rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 26

Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së

1. Shtabi i Përgjithshëm përbënë strukturën organizative më të lartë ushtarake në FSK.
2. Shtabi i Përgjithshëm gjeneron forca të gatshme luftarake dhe operative për përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor.

Neni 27

Struktura e gradave

1. Të gjithë pjesëtarët e FSK-së bartin grada dhe kategorizohen në oficer, nënoficer dhe ushtar.
2. Gradat e oficerëve në FSK janë:
 - i. OF1* Nëntoger,
 - ii. OF1 Togër,
 - iii. OF2 Kapiten,
 - iv. OF3 Major,
 - v. OF4 Nënkolonel,
 - vi. OF5 Kolonel,
 - vii. OF6 Gjeneral brigade,
 - viii. OF7 Gjeneralmajor, dhe
 - ix. OF8 Gjenerallejtënant;
2. Gradat e ushtarëve dhe nënoficerëve në FSK janë:
 - i. OR2 Ushtar,
 - ii. OR3 Ushtar i Klasit të Parë,
 - iii. OR4 Tetar ose Specialist,
 - iv. OR5 Rreshter,
 - v. OR6 Rreshter Shtabor,
 - vi. OR7 Rreshter i Klasit të Parë,
 - vii. OR8 Rreshter i Parë ose Rreshter Master,
 - viii. OR9 Rreshter Major, Rreshter Major i Komandës ose Rreshter Major i FSK-së.
3. Rekrutët në FSK kategorizohen si OR1 (rekrutë) deri në periudhën e betimit.

Neni 28

Uniformat

1. Komandanti i FSK-së propozon dukjen e uniformave të FSK-së për miratim nga Presidenti.
2. Bartja e uniformave dhe dukja personale e pjesëtarëve të FSK-së, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

KREU V - SHËRBIMI NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Neni 29

Parametrat e shërbimit

1. Mosha minimale për të shërbyer në FSK është tetëmbëdhjetë (18) vjeç.
2. Mosha më e lartë për t'u rekrutuar në FSK është tridhjetë (30) vjeç për oficer dhe njëzetepesë (25) vjeç për grada të tjera (nënoficer, ushtar) në ditën e mbylljes së konkursit për aplikim.

Neni 30

Pranimi në Forcën e Sigurisë së Kosovës

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës mund të pranohen në FSK pasi të kenë plotësuar kërkesat dhe kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes.
2. Përzgjedhja bazohet në gjendjen shëndetësore dhe fizike dhe sipas nevojave e prioriteteve të FSK-së dhe pas përfundimit me sukses të procedurës së miratuar për rastet në të cilat kërkohet verifikimi i kontrollit të sigurisë, respektivisht pastërtisë së figurës, sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe akteve të brendshme nënligjore të ministrisë.
3. Pranimi në FSK konfirmohet pas përfundimit të trajnimit bazik, gjatë së cilës kohë, shtetasit do të cilësohen si rekrutë.
4. Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësohen për t'u pranuar si pjesëtar i FSK-së, janë:
 - 4.1. të jetë shtetas i Kosovës;
 - 4.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - 4.3. të përmbushë nivelin e kërkuar arsimor;
 - 4.4. të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore e fizike për vendin e shërbimit;
 - 4.5. të mos jetë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;
5. Pranimi në Forcën e Sigurisë së Kosovës bëhet si kadetë për kategorinë e oficerëve dhe si rekrutë për kategorinë e ushtarëve. Pas kryerjes së studimeve akademike ushtarake, kadetët marrin gradën më të ulët të oficerit, ndërsa rekrutët pas trajnimit bazik, marrin gradën e ushtarit.
6. Përgjithësimet nga parametrat e shërbimit bëhen për personelin profesional të kualifikuar, që punësohet për të kryer punë specifike të specializuara, që përfshinë por nuk kufizohet vetëm në personelin mjekësor, të cilët mund të ngritën në detyrë në gradën që është proporcionale me kualifikimet profesionale dhe emërimin e tyre.
7. Kriteret dhe kushtet e tjera për pranim në FSK, përveç se parashikohen në këtë ligj, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 31

Betimi

1. Ditën e emërimit si oficer dhe nënoficer aktiv dhe rezervë i FSK-së, pjesëtari bën betimin.
2. Deklarata e betimit është:

"Betohe më solemnisht se do të jem i përkushtuar dhe do t'i qëndroj plotësisht besnik Republikës së Kosovës, se do t'iu bindem urdhrave të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe oficerëve tjerë mbi mua, në pajtim me ligjin, dhe se do t'i kryej detyrat e mia me zell, nder dhe dinjitet. Betohe më solemnisht se do të zbatoj Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do t'i shërbej popullit dhe Atdheut tim, dhe për mbrojtjen e tyre, nuk do të kursej as jetën time! Betohe më!"

Neni 32
Rregullat, kohëzgjatja dhe kushtet e shërbimit

1. Ministri nxjerr rregulla dhe akte nënligjore që trajtojnë rregullat, kohëzgjatjen dhe kushtet e shërbimit në FSK.
2. Kohëzgjatja e shërbimit është e ndarë në angazhim afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.
3. Pjesëtari rezervë gjatë kohës së angazhimit i nënshtrohet rregullave dhe kushteve të shërbimit sikurse pjesëtari aktiv.

Neni 33
Zhvillimi i karrierës

1. Me pranimin në FSK, pjesëtari aktiv si ushtar, nënoficer dhe oficer, gëzon të drejtën e gradimit dhe të karrierës ushtarake.
2. Zhvillimi i karrierës së pjesëtarit të FSK-së përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 34
Medaljet dhe mirënjohjet

1. Shërbimi meritor dhe veprat e trimërisë nga ana e pjesëtarëve të FSK-së, njihen nëpërmjet medaljeve, lëvdatave, shpërblimeve dhe mirënjohjeve.
2. Presidenti për pjesëtarët e FSK-së jep dekorata në pajtim me ligjin përkatës në fuqi për dekorata.
3. Ministri dhe KOMFSK janë të autorizuar t'u japin medalje, lëvdata, shpërblime dhe mirënjohje pjesëtarëve të FSK-së, personave fizikë dhe juridikë të vendit dhe të huaj, që e kanë dalluar vetën me meritat e tyre për FSK.
4. Hollësitë për zbatimin e paragrafit 3 të këtij neni, duke përfshirë edhe llojet e dekoratave përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 35
Të dhënat personale dhe dosja e personelit

1. Pas pranimin në FSK, secilit pjesëtar i caktohet numri unik personal, i cili përbën bazën për të gjitha shënimet personale dhe ato të karrierës.
2. Secilit pjesëtar aktiv dhe rezervë të FSK-së i lëshohet kartela personale e identifikimit me të cilën vërtetohet pranimi i tij/saj në FSK. Kartela duhet të mbahet gjatë tërë kohës derisa pjesëtari është në detyrë.
3. Ministria dhe Shtabi i Përgjithshëm të FSK-së janë përgjegjëse për zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës për kontrollimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e dosjeve të personelit të FSK-së, për të siguruar mbrojtjen e të drejtës së individit për privatësi.
4. Rregullat e hollësishme për të dhënat personale dhe dosjen e personelit përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 36

Orari i punës

1. Kohëzgjatja e rregullt e orarit të punës për në FSK, është e njëjtë me atë të administratës publike.
2. Në rrethana normale, pjesëtarëve aktivë të FSK-së ju kërkohet të punojnë mesatarisht dyzet (40) orë në javë dhe së paku një (1) ditë e plotë (24 orë të njëpasnjëshme) pushim në shtatë (7) ditë.
3. Përfundimisht nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, orari i punës për FSK mund të zgjatet për nevoja të shërbimit të brendshëm, gatishmërisë, stërvitjeve dhe operacioneve.
4. Përcaktimi i orarit të punës në FSK bëhet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 37

Pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera

1. E drejta në pagë, shtesat mbi pagë dhe llojet tjera të kompensimit janë të garantuara për të gjithë personelin e FSK-së.
2. Si shtesë e pagës, pjesëtarët e FSK-së në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe benificione. Pagesat e tilla shtesë bazohen në faktorët duke përfshirë, por jo të kufizohen vetëm në detyrat e rrezikshme, punën nën stres, punën jashtë orarit, orarin e punës me ndërime, punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për shkathtësi të veçanta.
3. Pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera përcaktohen dhe paguhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

Neni 38

Pushimet dhe ngjarjet përkujtimore

1. Pjesëtari aktiv i FSK-së gëzon të drejtën e pushimit javor, pushimit vjetor të paguar dhe të pushimeve të tjera të përcaktuara me akte të tjera ligjore e nënligjore.
2. Pushimet në Forcën e Sigurisë së Kosovës menaxhohen dhe autorizohet përmes zinxhirit komandues.
3. Përcaktimi i llojeve, kriterëve, kohëzgjatjes dhe procedurave për dhënien dhe shfrytëzimin e pushimeve në FSK rregullohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.
4. Në pajtim me kërkesat për mbulueshmërinë me personel, siç përcaktohet me detyrat dhe përgjegjësitë e FSK-së, FSK-ja mund të shënojë edhe ditët dhe festat e shënuara kombëtare apo shtetërore dhe ngjarjeve tjera përkujtimore që u përgjigjen datave që kanë të bëjnë me krijimin dhe aktivitetet e saj.
5. Të gjitha pushimet e përcaktuara sipas këtij neni mund të anulohen, shtyhen ose ndërpriten për të përmbushur kërkesat operative të paparashikueshme apo ato të caktuara brenda një kohe të shkurtër.

Neni 39
Ushqimi, transporti dhe akomodimi

Ushqimi, transporti dhe akomodimi për personelin e FSK-së, rregullohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 40
Kujdesi shëndetësor dhe siguria në punë

1. Të drejtën për kujdesin shëndetësor e gëzon i gjithë personeli i FSK-së.
2. Kujdesi shëndetësor primar duhet të ofrohet, aty ku është e mundshme, brenda burimeve vetanake të FSK-së. Kur kjo nuk është e mundshme, ose kur kërkesa është jashtë fushës të cilën e mbulon Shërbimi Mjekësor i FSK-së, pjesëtarët duhet të dërgohen në sistemin e kujdesit shëndetësor kombëtar.
3. Organizmi dhe funksionimi i shërbimit mjekësor, si dhe përcaktimi i masave mbrojtëse dhe standardeve mjekësore të shërbimit, rregullohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 41
Masat mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse përcaktohen sipas shkallës së rrezikshmërisë gjatë stërvitjeve dhe operacioneve.
2. Masat mbrojtëse të shërbimit përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 42
Ndërprerja e shërbimit

1. Shërbimi në FSK mund të ndërpritet në mënyrë vullnetare dhe të detyrueshme.
2. Të gjitha ndërprerjet e shërbimit, përveç atyre që bëhen për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 43
Ndërprerja vullnetare e shërbimit

1. Pa marrë parasysh gradën e tyre, të gjithë pjesëtarët aktivë të FSK-së, kanë të drejtë të ndërpresin vullnetarisht shërbimin e tyre pas lajmërimit paraprak të ndërprerjes në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh.
2. Përfundim nga paragrafi 1 i këtij neni paraqesin rastet në të cilat pjesëtarët kanë marrë pjesë në shkollim dhe trajnim të paguar dhe ju kërkohet të shërbejnë për një periudhë kohore të paracaktuar pas atij trajnimit, me qëllim të kthimit të investimit të bërë nga FSK-ja.
3. Rekrutët e FSK-së kanë të drejtë të tërhiqen/ndërpresin trajnimin pa ndonjë detyrim tjetër përfshirë edhe trajnimin, nëse këtë e bëjnë gjatë tri (3) javëve të para.

Neni 44
Ndërprerja e detyrueshme e shërbimit

1. Pa marrë parasysh gradën e tyre, shërbimi i çdo pjesëtari të FSK-së, mund të përfundojë në mënyrë të detyrueshme nën rrethanat e poshtëshënuara:
 - 1.1. arrin moshën për pension;
 - 1.2. ka dhënë shënime të rrejshme gjatë procesit të rekrutimit;
 - 1.3. dështon në plotësimin e standardeve të kërkuara gjatë trajnimit të rekrutimit;
 - 1.4. dështon në mbajtjen e gjendjes të kërkuar fizike ose mjekësore, përjashtimisht rasteve që rezultojnë si pasojë nga shërbimi në FSK dhe ka mundësi të ri-caktimit;
 - 1.5. është dënuar për veprë penale;
 - 1.6. ka vendim të Bordit Disiplinor të FSK-së;
 - 1.7. ka marrë post politik ose ka pjesëmarrje në mënyrë aktive në veprimtarinë politike partiake.

KREU VI - STATUSI I PJESËTARIT TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Neni 45
Fitimi i statusit të pjesëtarit të FSK-së

1. Shtetasi i Republikës së Kosovës, nga dita e fillimit të shërbimit në FSK, fiton statusin e pjesëtarit të FSK-së dhe gëzon të gjitha drejtat dhe përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.
2. Statusin e pjesëtarit të FSK-së e gëzojnë:
 - 2.1. pjesëtarët e shërbimit aktiv;
 - 2.2. pjesëtarët e shërbimit rezervë;
 - 2.3. rekrutët dhe
 - 2.4. kadetët.

Neni 46
Ruajtja e statusit të pjesëtarit të FSK-së

Në çdo kohë, nëse pjesëtari i FSK-së kapet rob apo merret peng, në territorin e Republikës së Kosovës ose në territorin e një shteti tjetër, ruan të drejtat dhe obligimet që i njeh statusi i pjesëtarit të FSK-së.

Neni 47
Humbja e statusit të pjesëtarit të FSK-së

1. Statusi i pjesëtarit të FSK-së humbet në rastet kur:
 - 1.1. dënohet me burgim nga gjykata me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje;
 - 1.2. pjesëtari njëanshëm ndërprente shërbimin në FSK pa shkaqe ligjore;
 - 1.3. vdes.

Neni 48
Të drejtat e pjesëtarit të FSK-së

1. Është e drejtë e çdo pjesëtarit të FSK-së të gëzojë trajtim të drejtë dhe të barabartë, të çmohet dhe respektohet si individ dhe të mbështetet e shpërblehet sipas rregullave dhe kushteve të shërbimit.
2. Të drejtat e pjesëtarit të FSK-së, në veçanti përfshijnë:
 - 2.1. punë të garantuar në FSK në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - 1.1. trajtim të drejtë dhe të barabartë pa diskriminim në bazë të ligjit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;
 - 1.2. mbrojtje shtetërore në kryerjen e detyrave të ngarkuara;
 - 1.3. mbajtje dhe përdorim të armës në përputhje me ligjin dhe rregullat përkatëse gjatë kryerjes së shërbimit dhe jashtë tij;
 - 1.4. mundësi në zhvillimin e plotë të karrierës për të realizuar plotësisht potencialin e tij përmes procedurave të emërimit, gradimit dhe zhvillimit në bazë të meritokracisë dhe në pajtim me procedurat e përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore;
 - 1.5. të drejtën që në mënyrë individuale të paraqesin sipas rastit kërkesa ose ankesa për veprime të paligjshme të eprorëve në rastet kur u cenohen të drejtat e tyre, si dhe shqyrtimin e tyre nga ana e zinxhirit komandues në mënyrë të drejtë dhe pa paragjykim për perspektivat aktuale ose të ardhshme të karrierës;
 - 1.6. të trajnohet, të kualifikohet dhe të ndjekë studimet në institucionet arsimore, ushtarake ose civile, brenda dhe jashtë vendit, vetëm kur i jepet leje, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.7. të organizohet në shoqata, të cilat nuk kanë karakter politik ose sindikalist.
2. Sipas nevojave për përfaqësim të FSK-së, pjesëtarët e FSK-së kanë të drejtë të përzgjidhen për të shërbyer si atashe të mbrojtjes në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, oficer/nënoficer ndërlidhës në organizata dhe institucione ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes, apo për të shërbyer jashtë vendit, sipas marrëveshjeve bilaterale, për shkëmbimit të personelit me qëllim të shkëmbimit të përvojave. Për zbatimin e këtij paragrafi Qeveria nxjerr akt të veçantë nënligjor.

Neni 49
Obligimet e pjesëtarit të FSK-së

1. Është detyrë dhe obligim i çdo pjesëtarit të FSK-së t'i shërbejë Republikës së Kosovës me besnikëri dhe ndershmëri, për të mbrojtur të drejtat dhe lirinë e popullit dhe të respektojë rendin kushtetues.
2. Obligimet e pjesëtarit të FSK-së, në veçanti, përfshijnë këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 1.1. të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

- 1.2. të kryejë të gjitha detyrat që i caktohen në mënyrë të përgjegjshme, me nder, me paanshmëri dhe në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë dhe me të gjitha aktet e brendshme ligjore e nënligjore;
- 1.3. të ruajë kurdoherë nderin e dinjitetin e ushtarakut;
- 1.4. të shërbejë kudo që kërkojnë interesat e FSK-së;
- 1.5. t'i bindet eprorit/ zinxhirit komandues;
- 1.6. të zbatojë të gjitha urdhrat e ligjshëm që jepen për qëllime shërbimi edhe në rast se paraqet rrezik për jetën e tij;
- 1.7. t'ia bëjë të ditur eprorit dhe të kërkojë dhënien me shkrim të urdhrit, kur urdhri bie në kundërshtim me ligjin;
- 1.8. të mos zbatojë urdhrat që bien në kundërshtim të hapur me ligjin dhe të njoftojë urdhërdhënësin dhe eprorin e vet;
- 1.9. të përgatitet ushtarakisht, të jetë i gatshëm dhe i disiplinuar, për çdo sakrificë, deri në dhënien e jetës për mbrojtjen e atdheut;
- 1.10. të mbrojë të gjitha informatat, në çfarëdo forme, si dhe pajisjet e marra ose që i janë dhënë gjatë detyrës në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë sigurinë e informatave dhe të pajisjeve;
- 1.11. të respektojë orarin e punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave;
- 1.12. të mbajë uniformën dhe simbolet e FSK-së në përputhje me legjislacionin përkatës;
- 1.13. të veprojë me integritet gjatë gjithë kohës dhe të mos e keqpërdorë pozitën zyrtare ose informatat zyrtare për përfitim të tij/saj personal ose të tjerëve;
- 1.14. të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim material, për kryerjen e detyrave, me përjashtim të pagës dhe të përfitimeve të tjera, të përcaktuara me ligj e akte të tjera nënligjore;
- 1.15. mosdhënien e deklaratave publike përmes mediumeve dhe formave tjera të komunikimit publik që kanë të bëjnë me FSK-në, pjesëtarët ose aktivitetet e saj pa marrë paraprakisht pëlqimin përmes zinxhirit komandues;
- 1.16. të shmangë çfarëdo aktiviteti që mund të përbëjë konflikt të interesit ndërmjet detyrave zyrtare dhe private;
